



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 586/25 Datë: 27.05.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 137 të mbajtur më 19.05.2025, mori:

V E N D I M

- I.** Riakreditohen programet e studimeve të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2030):
 - *Teknologji Ushqimore, BSc 180 ECTS; me kuotë 50 studente për vit akademik.*
 - *Art Performues, BA 240 ECTS; me kuotë 20 studente për vit akademik.*
- II.** Akreditohen programet e studimeve të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë për periudhën tri (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 - *Ekologji e Aplikuar ne Agrobiznes, BSc 180 ECTS; me kuotë 40 studente për vit akademik.*
 - *Art Performues, MA 60 ECTS; me kuotë 10 studente për vit akademik.*
- III.** Numri i studentëve vlen dhe zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV.** Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V.** Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VI.** Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	Teknologji Ushqimore, BSc 180 ECTS;	Arsim Elshani, Ibrahim Hoxha dhe Arieta Camaj Ibrahim.
2.	Art Performues, BA 240 ECTS;	Mimoza Drancolli, Dardane Nallbani, Besa Berberi dhe Fatbardh Gashi.
3.	Ekologji e Aplikuar ne Agrobiznes, BSc 180 ECTS;	Milaim Musliu, Irir Morina, Gjoke Duhanaj dhe Naser Bajraktari.
4.	Art Performues, MA 60 ECTS;	Dardan Gjinolli.

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; Teknologji Ushqimore, BSc 180 ECTS; vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 19.02.2025 me këtë përbërje: Kyriaki Zinoviadou, Damir Magdic dhe Gaga Gvenetadze. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht tre (3) fushë të standardeve të akreditimit.

Për programin e studimit; Art Performues, BA 240 ECTS; vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 25.04.2025 me këtë përbërje: Darko Lukic, John Butler dhe Katerina Klimoska. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit.

Për programin e studimit; Ekologji e Aplikuar ne Agrobiznes, BSc 180 ECTS; vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 19.02.2025 me këtë përbërje: Joachim Muller, Sanja

Kalambura dhe Ştefania Armăşelu. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.

Për programin e studimit; Edukim Artistik ne Interpretim, MA 60 ECTS; vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 25.04.2025 me këtë përbërje: Darko Lukic, John Butler dhe Katerina Klimoska. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 137-të, të mbajtur më datë 19.05.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë